



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 418/6 prot.

Tiranë, 26.10.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 11.10.2018, është njoftuar vendimi nr. 62, datë 3.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 10.8.2018, është depozituar akti “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Zoti Artur Malaj ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, është subjekt rivlerësimi dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Në bazë të nenit 282, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi në kohë.

3. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj z. Artur Malaj ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (në vijim referuar si Inspektorati), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Artur Malaj<sup>1</sup>”, ka referuar se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin<sup>2</sup>, ka referuar “Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

<sup>1</sup> Protokolluar pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2017.

<sup>2</sup> Shkresa e DSIK-së me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2017 (deklasifikuar pjesërisht).

3.3 Inspektorati i KLD-së, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit<sup>3</sup>, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (6 të tilla), Komisioni konstatoi se ky subjekt ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, duke arritur në konkluzionin se subjekti mund të konsiderohet “I aftë”.

**4.** Komisioni pas hetimit administrativ (zhvilluar gjatë periudhës 30.11.2017 - 5.7.2018) dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për secilin kriter, në mënyrë të përmbledhur ka arritur në përfundimet si vijon:

**4.1 Për vlerësimin e pasurisë.** Bazuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar pasaktësi në deklaratimet e subjektit, të cilat ka çmuar se nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Në këto kushte, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës<sup>4</sup> për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve, përmbledhur si vijon:

*4.1.1 Subjekti ka kryer deklarin të pasaktë lidhur me vlerën e apartamentit të deklaruar në DPV/2005 dhe në Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar - “Vetting”.*

*4.1.2 Subjekti ka paraqitur dokumentacion fiktiv (aktmarrëveshje), me qëllimin përfundimtar të përcaktimit të vlerës së apartamentit dhe të garazhit në vlerën totale prej 5,500,000 lekësh. Në bazë të kësaj aktmarrëveshjeje fiktive, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria e ndërtimit kanë përcaktuar çmimet fiktive të këtyre pasurive edhe në kontratat noteriale të shitblerjes të nënshkruara në vitin 2008.*

*4.1.3 Subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, duke fshehur vlerën reale të blerjes së apartamentit.*

*4.1.4 Nga analiza financiare e kryer konstatohet se subjekti nuk disponon burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera për prenotimin e këtij apartamenti. Në rastin më të mirë të shumës prej 15,130 eurosh, të likuiduar më datë \*\*\*.5.2005, ditën e nënshkrimit të kontratës noteriale. Në rastin më të keq, të shumës prej 30,130 eurosh, duke i shtuar këtu edhe shumën prej 15,000 eurosh, që ka pasur detyrim të paguajë më datë \*\*\*.7.2005, kjo para disbursimit të kredisë nga “\*\*\*”.*

*4.1.5 Subjekti ka fshehur pronësinë e një vile 3-katëshe, të ndodhur në afërsi të shkollës “\*\*\*”, \*\*\*; për të cilën ka indicie se është në pronësi të subjektit të rivlerësimit.*

<sup>3</sup> Shkresa e Inspektoratit të KLD-së, nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2017.

<sup>4</sup> Referohu akteve në dosje.

4.1.6 Subjekti ka bërë deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm pranë Komisionit lidhur me kreditimin (financimin) e llogarive bankare të tij, nuk ka deklaruar këto të ardhura të kredituara në llogarinë e tij dhe burimin e krijimit të tyre.

4.1.7 Subjekti mund të ketë kontribut në krijimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur.

4.2 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës për gjetjet e mësipërme, në përfundim ka konkluduar se: *“...Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarinet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit”* (f. 40 e vendimit).

4.3 **Për kontrollin e figurës.** Bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar mbi raportin e sjellë nga DSIK-ja, ku grupi i punës pranë këtij institucioni kishte konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për të vazhduar detyrën. Nga hetimi në tërësi lidhur me raportin e DSIK-së, Komisioni konstatoi se *informacioni i përcjellë nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i paplotë. Informacioni në çdo rast duhet të jetë i bazuar mbi prova të sakta, kjo është edhe fryma e ligjit për krijimin e grupit të punës. Nëse grupi i punës nuk do të bëjë një verifikim të plotë, atëherë ai rrezikon të nxjerrë përfundime të gabuara dhe të rëndojë pozitën e subjekteve të rivlerësimit. Në këtë rast, grupi i punës nuk ka kryer verifikime të mëtejshme, duke arritur në konkluzion vetëm mbi bazën e informacionit të paverifikuar. Në këto kushte, duke analizuar raportin e ardhur nga DSIK-ja dhe organet ligjzbatuese, duke bërë një studim të thelluar të tyre, duke administruar provat e tjera në lidhje me çështjen, Komisioni çmon se informacioni mbi të cilin ka ardhur rekomandimi i DSIK-së **rezulton i pasaktë dhe i pabazuar në***

*prova dhe fakte, për pasojë subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës (f.47 e vendimit).*

**4.4 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, nenin 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas administrimit dhe analizimit të raportit të përgatitur nga Inspektorati i KLD-së, vlerësimit të 6 denoncimeve nga publiku, në përfundim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit mund të konsiderohet “i aftë” (f. 56 e vendimit).

**5.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Artur Malaj, me detyrë gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

## **II. A Shkaqet e ankimit**

**6.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (*Vetting*).

**7.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**8.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

**9.** Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit.

**10.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga Komisioni, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së (bashkëlidhur këtij ankimi), vlerëson se

vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme për t'iu paraqitur juridiksionit rishikues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vendimmarrje.

**11.** Komisioneri Publik konstaton se në arritjen e përfundimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në arsytetime dhe interpretime kontradiktore lidhur me përmbajtjen dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe legjislacionit të posaçëm, lidhur me *konceptin persona të tjerë të lidhur, mbi detyrimin e tyre apo të subjekteve për të deklaruar dhe justifikuar vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të këtyre personave, si dhe me pasojat që sjell për subjektin e rivlerësimit mosjustifikimi i pasurisë së këtyre personave me të ardhura të ligjshme.*

**12.** Kështu, Komisioneri Publik nuk pajtohet me sa konkludon Komisioni lidhur me personat e tjerë të lidhur, ku shprehet se: *“Megjithëse personat e tjerë të lidhur, për të cilët ky Komision ka kryer hetim pasuror, nuk janë në kushtet e parashikuara në pikën 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin...”, në cilësinë e huadhënësit, huamarrësit apo dhuruesit, mbi bazën e të cilit kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, Komisioni vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ana e subjektit lidhur me këto pasuri duken bindëse dhe se nuk ka dyshime se subjekti i rivlerësimit të ketë lidhje me këto pasuri<sup>4</sup>”.*

12.1 Qëllimi i nenit D, të aneksit të Kushtetutës, është të identifikojë ato subjekte të rivlerësimit, të cilat kanë pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Për të arritur këtë qëllim, kontrolli i pasurisë ka në objektin e tij jo vetëm subjektet e rivlerësimit, por edhe dy kategori të tjera, atë të personave të lidhur dhe atë të personave të tjerë të lidhur. Ligji 84/2016 përkufizon si persona të tjerë të lidhur *“...personat fizikë ose juridikë që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit... që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”<sup>5</sup>*. Kjo lidhje interesi pasuror apo marrëdhënie biznesi është parakusht për të bërë kualifikimin si persona të tjerë të lidhur. Format e shprehjes së interesit pasuror apo marrëdhënies së biznesit janë të shumëllojshme, disa prej tyre janë përmendur edhe në nenin 32, pika 4, të ligjit 84/2016, të tilla si: dhurimi, huamarrja, huadhënie si rastet që hasen më shpesh në praktikë. Këto forma të shprehura të interesit pasuror apo marrëdhënies së biznesit nuk janë shteruese ndaj dhe, sipas rastit, mund të hasen në forma të tjera shfaqjeje, për të cilat duhet të shprehet Komisioni bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes.

<sup>4</sup> F.37, paragrafi 3 dhe f. 40, paragrafi 4, i vendimit.

<sup>5</sup> Ligji 84/2016, neni 3, pika 14.

12.2 Në rastin konkret, Komisioni arsyeton në mënyrë kontradiktore, duke cilësuar se ka kryer hetim pasuror mbi personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ndërkohë që nuk shprehet mbi rezultatet e hetimit pasuror nëse ata (personat e tjerë të lidhur) e kanë përmbushur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Pra, nga njëra anë, për efekt hetimi administrativ i kualifikon si persona të tjerë të lidhur, duke u referuar në ligjin 84/2016, pikën 14, të nenit 3, ndërsa, për efekt marrje vendimi, nuk i kualifikon si persona të tjerë të lidhur në referim të pikës 4, të nenit 32, të të njëjtit ligj.

12.3 Rrethanat konkrete, për të cilat Komisioneri Publik vlerëson se 3 shtetas për të cilët është zhvilluar hetimi administrativ nga Komisioni duhen cilësuar si persona të tjerë të lidhur, trajtohen në vijim të këtij ankimi.

**13.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon kriterit të pasurisë, referuar kërkesave të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e tjera të administruara.

13.1 Në këtë drejtim, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (periodike dhe ajo *Vetting*), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (e paluajtshme/e luajtshme/likuiditetet).

13.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, referuar provave dhe gjetjeve nga hetimi administrativ në raport me dokumentet dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, çmon se ky i fundit për kriterin e kontrollit të pasurisë nuk ka deklaruar saktë dhe mjaftueshëm pasuritë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, ndaj kundër tij zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 (barra e provës), subjekti nuk ka arritur të provojë me prova dhe shpjegime bindëse të kundërtën e rezultateve të hetimit, rrjedhimisht edhe përfundimet e arritura nga Komisioni për vlerësimin e pasurisë së subjektit nuk gjenden të drejta.

**14.** Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit, ushtrohet për vlerësimin e gabuar të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj.

## II. B Vlerësimi i pasurisë

15. Komisioneri Publik ka vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për 1(një) pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit z. Malaj, në deklaratën periodike të vitit 2005 dhe në Deklaratën “Vetting” dorëzuar në ILDKPKI, në datë 30.1.2017.

### 16. Pasuria 1

16.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sipërfaqe 106.7 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Rruga “\*\*\*\*”(\*\*\*\*), \*\*\*\* me vleftë 5.000.000 lekë. Pjesët takuese 50% me 50 % me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: kredi me vlerën 5.000.000 lekë në \*\*\*\*.

16.2 Në Deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: Prenotim apartamenti me sipërfaqe rreth 102 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, \*\*\*\*, me vleftë rreth 55.000 euro. Pjesët takuese të paspecifikuara. Si burim i krijimit të pasurisë, është deklaruar: vlera e kredisë prej 5.000.000 lekë, pjesa tjetër në përfundim.

16.3 Në fashikull të Komisionit janë administruar:

- i. Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr.\*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., e datës \*\*\*\*.10.2008, lidhur në \*\*\*\*, para noteres \*\*\*\*, me palë shitës Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me palë blerës Artur dhe \*\*\*\* Malaj. Objekti i kontratës është apartamenti nr.\*\*\*\*, kati \*\*\*\*, me sipërfaqe 106.7 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Tiranë me nr.\*\*\*\*, datë \*\*\*\*.9.2008. Çmimi i caktuar në kontratë është 46.860 lekë për metër katrorë ose shumë e përgjithshme prej 5.000.000 lekë.
- ii. Kontratë sipërmarrje me nr.\*\*\*\* rep., nr.\*\*\*\* kol., e datës \*\*\*\*.5.2005, lidhur në \*\*\*\*, para noteres \*\*\*\*, me palë sipërmarrëse Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë porositëse Artur Malaj. Objekti i kontratës apartament me sipërfaqe 117,5 m<sup>2</sup>. Çmimi i caktuar është 61.100 euro. Mënyra e pagesës më këste, ku kësti i parë në vlerën 15.130 euro u pagua sot me lidhjen e kontratës.
- iii. Kontratë kredie bankare me nr.\*\*\*\* rep. nr.\*\*\*\* kol., e datës \*\*\*\*.9.2005, lidhur në \*\*\*\*, para noteres \*\*\*\*, me kredihënës \*\*\*\* sh.a. dhe kredimarrës Artur Malaj. Objekti është kredi në shumën 5.000.000 lekë, më qëllim blerje apartamenti.
- iv. Kontratë hipoteke me nr.\*\*\*\* rep. \*\*\*\* kol., e datës \*\*\*\*.9.2005, lidhur në \*\*\*\*, para noteres \*\*\*\*, me hipotekues \*\*\*\* dhe \*\*\*\* dhe përfitues \*\*\*\*, për të garantuar kthimin e kredisë së marrë nga z. Artur Malaj, për blerje apartamenti. Hipoteka është vendosur mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 134.4 m<sup>2</sup>, me numër pasurie \*\*\*\*, zona kadastrale \*\*\*\*, \*\*\*\*.
- v. Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim i datës \*\*\*\* maj 2008, mbajtur ndërmjet shoqërisë ndërtuese \*\*\*\* dhe porositësit Artur Malaj.
- vi. Revokim kontrate me nr.\*\*\*\* prot., e datës \*\*\*\*.7.2005, me deklarues z. Artur Malaj dhe z. \*\*\*\*, administrator i \*\*\*\* sh.p.k.



16.4 Me qëllim vlerësimin mbi saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit, burimin e ligjshëm, mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë, analiza do të bazohet në identifikimin e akteve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, përputhshmërinë e të dhënave për sa i përket deklaramive, vleftave dhe burimit të krijimit.

16.5 Origjina e pronës. Nga shqyrtimi i akteve, konstatojmë se origjina e krijimit të kësaj pasurie rezulton të jetë (i) kontrata e sipërmarrjes, e datës \*\*\*.5.2005 dhe (ii) kontrata e shitjes të pasurisë së paluajtshme, e datës \*\*\*.10.2008, sipas të dhënave të përshkruara sa më sipër në pikën 16.3. “i” dhe “ii”.

16.6 *Kronologjia* e fakteve ligjore të krijimit të pasurisë paraqitet si në vijim:

- i. Më datë \*\*\*.5.2005, lidhet kontrata e sipërmarrjes me objekt një apartament me sipërfaqe 117m<sup>2</sup>, me sipërfaqe të përbashkëta të apartamenteve sipas përcaktimeve të neneve 209 dhe 210 të Kodit Civil. Çmimi i caktuar 61.000 euro, mënyra e pagesës me këste, kësti i parë 15.130 euro është paguar ditën e lidhjes së kësaj kontrate (datë \*\*\*.5.2005), kësti i dytë, 15.000 euro, më datë \*\*\* korrik 2005, kësti i tretë, 20.000 euro, në tetor 2005 dhe kësti i fundit, me diferencë prej 10.970 eurosh, kur të bëhet kontrata e shitjes (neni 4).
- ii. Më datë \*\*\*.7.2005 është nënshkruar mes z. Artur Malaj (subjekti i rivlerësimit) dhe shoqërisë \*\*\* sh.p.k., revokimi i kontratës, datë \*\*\*.5.2005, me shkakun se z. Malaj nuk ka përmbushur asnjë nga detyrimet e kontratës, me argumentin se nuk i është disbursuar kredia nga \*\*\*. Po në këtë revokim kontrate, palët kishin rënë dakord ta konsiderojnë pa efekt dhe të zgjidhur kontratën e sipërmarrjes të datës \*\*\*.5.2005, si dhe heqin dorë nga çdo pretendim për detyrimet që rrjedhin prej saj dhe ta konsiderojnë të zgjidhur kontratën e sipërmarrjes së datës \*\*\*.5.2005. Për sa përshkruar këtu, subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, më datë \*\*\* korrik 2018, i ka paraqitur Komisionit një shkresë private, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe administratori i shoqërisë \*\*\*, e cila nuk përmbush kushtet e nenit 257 dhe 253, të Kodit të Procedurës Civile, ndaj dhe nuk përbën provë. Sipas nenit 257 të KPr.C, shkresat për kryerjen ose vërtetimin e veprimit juridik, për sa u përket deklaramit të palëve duhet të përpilohen në bazë të nenit 253 që të përbëjnë provë të plotë për të gjithë. Sipas nenit 253, aktet zyrtare që përpilohen nga personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e përcaktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramive që janë bërë përpara tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Në kuptim të këtyre rregullimeve ligjore, akti revokim kontrate, për të qenë i rregullt, duhet të ndiqte rrugën formale të kërkuar nga dispozitat ligjore, të lidhej para noterit dhe të dorëzohej së bashku me dokumentacionin tjetër që subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së. Si rrjedhojë, shkresa private e pretenduar si revokim kontrate nga ana e

subjektit të rivlerësimit nuk përbën provë, ndaj dhe përmbajtja e saj nuk ka efekt mbi vlerësimin e rrethanave të krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, pretendimi për revokim kontrate, bie në kundërshtim me deklarin periodik të vitit 2005 (dorëzuar më datë *\*\*\*.3.2006*), ku përshkruhet fakti, citojmë: “*prenotim apartamenti...me kontratë sipërmarrje me firmën \*\*\* datë \*\*\*.5.2005*”, si dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim të apartamentit, mbajtur më datë *\*\*\*.5.2008*, ku thuhet, citojmë “*...porositësi ka negociuar dhe prenotuar për një apartament banimi dhe një garazh që në muajin maj të vitit 2005..*”, periudhë e cila korrespondon me muajin kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes. Si konkluzion në vlerësimin tonë, ky akt revokimi kontrate nuk është një akt zyrtar në kuptim të nenit 253, të Kodit të Procedurës Civile. Sipas nesh, ky revokim kontrate duhet të ishte në formën e aktit noterial dhe të ishte dorëzuar në ILDKPKI. Për ne, revokimi i kontratës nuk përbën provë dhe nuk duhej të merrej parasysh nga Komisioni.

- iii. Më datë *\*\*\*.9.2005* lidhet kontrata e kredisë bankare ndërmjet *\*\*\* sh.a.* dhe Artur e *\*\*\* Malaj*, për shumën 5.000.000 lekë, me qëllim blerje apartamenti.
- iv. Më datë *\*\*\*.9.2005* lidhet kontrata e hipotekës ndërmjet *\*\*\* sh.a.* dhe *\*\*\* e \*\*\**, me kolateral apartamentin prej 134.4 m<sup>2</sup> në pronësi të tyre, me qëllim për të garantuar shlyerjen e plotë dhe të pakushtëzuar të detyrimeve sipas kontratës së kredisë bankare të sipërcituar.
- v. Më datë *\*\*\*.9.2005*, kredia në shumën 5.000.000 lekë disbursohet në llogari të Artur Malaj.
- vi. Më datë *\*\*\*.9.2005*, shuma prej 5.000.000 lekë transferohet nga llogaria e Artur Malaj në llogari të Shoqërisë *\*\*\**.
- vii. Më datë *\*\*\*.5.2008* lidhet “*Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim*” ndërmjet palëve shoqëri ndërtuese dhe porositës, ku thuhet se vlera përfundimtare e shitjes së apartamentit do të jetë 5.000.000 lekë, shumë kjo e likuiduar totalisht nga porositësi. Kjo situatë përshkruhet në shkresën private të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, e cila nuk përmbush kushtet e nenit 257 dhe 253, të Kodit të Procedurës Civile, ndaj dhe nuk përbën provë. Të dhëna të tjera të pavërteta në këtë shkresë janë edhe ato për sipërfaqen e apartamentit, ku thuhet se dakordësia ishte për një sipërfaqe prej 117.5 m<sup>2</sup>, ndërkohë është 106.7 m<sup>2</sup>, pretendim i cili bie poshtë nga të dhënat e planvendosjes së apartamentit *\*\*\**, e cila është pjesë e akteve të regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe kontratës së shitblerjes, ku thuhet: sip. shfrytëzimi = 106.7m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi = 117.5 m<sup>2</sup>, pra sipërfaqja prej 117.5m<sup>2</sup> pasqyron sipërfaqen ndërtimore dhe është ditur nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Malaj. Gjithashtu, edhe pretendimi për dakordësi për garazh, me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup>, i mbyllur, nuk mbështetet në asnjë dispozitë të kontratës së sipërmarrjes, datë *\*\*\*.5.2005*, që citohet si

moment i parë i negocimit ndërmjet palëve, si dhe nuk është deklaruar në Deklaratën periodike të vitit 2005. Pasuri e llojit “garazh” është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2008 dhe më pas në Deklaratën Vetting. Nuk rezulton e provuar me akte shkresore se kjo pasuri është planifikuar më herët për t’u blerë nga subjekti i rivlerësimit, sikurse ai citon në Aktmarrëveshjen e datës \*\*\*.5.2008.

- viii. Në vlerësimin tonë, kjo Aktmarrëveshje nuk është akt zyrtar në kuptim të nenit 253, të Kodit të Procedurës Civile. Sipas nesh, kjo Aktmarrëveshje duhet të ishte në formën e aktit noterial, rrjedhimisht nuk duhet të ishte vlerësuar si provë nga Komisioni. Citojmë gjithashtu që sipërfaqja e apartamentit, edhe pse sipas certifikatës së pronësisë është 106.7 m<sup>2</sup>, në thelb, së bashku me gjithë ambientet në bashkëpronësi të detyrueshme, është 117,5 m<sup>2</sup>.
- ix. Më datë \*\*\*.10.2008 lidhet kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\* rep. \*\*\*kol., në \*\*\*, para noteres \*\*\*, me palë shitës Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me palë blerës Artur dhe \*\*\* Malaj. Objekti i kontratës është apartamenti nr.\*\*\*, kati \*\*\*, me sipërfaqe 106.7 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Tiranë me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.9.2008. Çmimi i caktuar në kontratë është 46.860 lekë për metra katrorë ose shuma e përgjithshme prej 5.000.000 lekësh. Çmimi për metra katrorë i caktuar në këtë kontratë është në shkelje të detyrimit të vendosur në udhëzimin nr. 5, datë 18.1.2008,<sup>6</sup> sipas të cilit, çmimi i shitjes për metra katrorë nuk duhet të jetë më i ulët se çmimi minimal fiskal, i përcaktuar në shtojcën e këtij udhëzimi, ku çmimi për zonën \*\*\* të Tiranës, ku është vendndodhja e këtij apartamenti, është 57.660 lekë/m<sup>2</sup>.

16.7 Komisioneri Publik konstaton se Komisioni në kontradiktë me provat e administruara në fashikull ka dalë në konkluzion të gabuar lidhur me vlerësimin e bërë për pretendimin për revokimin e kontratës, kur shprehet se: “... me anë të dokumentit revokim kontrate, të datës \*\*\*.7.2005, palët kanë shprehur vullnetin e tyre për zgjidhjen e kontratës së porosisë me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., të datës \*\*\*.5.2005, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pra, kjo kontratë është zgjidhur nga palët po në vitin 2005, rrjedhimisht është i bazuar pretendimi i subjektit se kjo kontratë, sa kohë që u zgjidh, u bë nul, nuk prodhoi efekte juridike, atëherë nuk kishte arsye të deklaronte një kontratë inekzistente në kuptimin ligjor”<sup>7</sup>, shkresa private revokim kontrate nuk përbën provë në kuptim të nenit 257 dhe 253 të Kodit të Procedurës Civile dhe, si rrjedhojë, mospërputhjet e vërejtura, ndërmjet deklaratës periodike të vitit 2005 dhe Deklaratës Vetting qëndrojnë.

16.8 Për sa më sipër konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht pasurinë, duke mos përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

<sup>6</sup> Udhëzim “Mbi tatimin për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.

<sup>7</sup> Referohu f.10, paragrafi 8, të vendimit të Komisionit.

16.9 *Mospërputhjet midis deklarimeve për vleftën e pasurive.* Nga aktet në fashikullin e Komisionit rezulton se deklarimi i kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit për sa i përket vleftës është i ndryshëm, krahasuar me të dhënat mes deklaratës periodike të vitit 2005, Deklaratës Vetting, kontratës së porosisë dhe kontratës së shitblerjes, sikurse pasqyrohet në tabelën në vijim:

**Tab.1. Vlefta e deklaruar për apartamentin**

Pasuria e paluajtshme	Kontrata e sipërmarrjes datë ***.5.2005	Deklarata periodike viti 2005	Kontrata e shitblerjes, datë ***.10.2008	Deklarata Vetting
Ap. banimi sip. 106.7 m <sup>2</sup>	61.100 euro	55.000 euro	5.000.000 lekë	5.000.000 lekë

16.10 *Për sa më sipër* konstatojmë se subjekti i rivlerësimit z. Malaj nuk ka deklaruar saktësisht vleftën e pasurisë, duke mos përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

16.11 *Mospërputhjet mbi burimin e deklaruar për blerjen e pasurisë.* Nga aktet në fashikullin e Komisionit rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar si burim kredinë e marrë pranë \*\*\*, në shumën 5.000.000 lekë, dhe pjesën tjetër të shumës do ta paguajë në përfundim të kontratës. Në Deklaratën Vetting, subjekti deklaroi si burim krijimi kredinë bankare në shumën 5.000.000 lekë. Ky deklarim bie në kontradiktë me aktet ligjore, të cilat kanë shërbyer për fitimin e kësaj pasurie të paluajtshme, të cilat pasqyrojnë vlefta të ndryshme.

16.12 *Vlerësimi mbi burimin financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë.* Nga aktet në fashikullin e Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit z. Malaj, në deklaratën e vitit 2003 dhe deklaratën periodike të vitit 2004, ka deklaruar respektivisht kursime nga të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes, vlerat 300.000 lekë në vitin 2003 dhe 360.000 lekë në vitin 2004. Në total, kursimi në *cash* i deklaruar i subjektit dhe bashkëshortes për vitet 2003-2004 rezulton 660.000 lekë. Referuar kontratës së sipërmarrjes së datës \*\*\*.5.2005, nenit 4, ku përcaktohen modalitetet e pagesës, thuhet se: “...kësti i parë në vlerën 15.130<sup>8</sup>euro u pagua sot me lidhjen e kësaj kontrate” dhe bazuar në deklaratimet periodike vjetore të subjektit për vitet 2003, 2004 deri në maj 2005, subjekti i rivlerësimit z. Malaj dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura/kursime të mjaftueshme të krijuara nga burime të ligjshme për të mbuluar pagesën e kështit të parë.

17. *Sa më sipër*, referuar gjendjes së akteve, subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë, duke mos përmbushur detyrimet e pikës 1, të nenit D, të

<sup>8</sup> 874.607 lekë me kurs zyrtar të datës \*\*\*.5.2015.

aneksit të Kushtetutës, nuk arrin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, si dhe ka dhënë informacione kontradiktore dhe të pavërteta, duke bërë deklarime fiktive.

## ***II. C Mbi kualifikimin si persona të tjerë të lidhur dhe justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë***

### **18. \*\*\* dhe \*\*\* (kunati dhe motra i subjektit të rivlerësimit)**

18.1 Shtetasit \*\*\* e \*\*\* duheshin kualifikuar nga Komisioni si persona të tjerë të lidhur dhe të justifikonin burimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme për arsyet në vijim:

18.1.1 Nga provat e administruara nga Komisioni rezulton se shtetasit \*\*\* dhe \*\*\* kanë lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, pasi janë “*garantor pasuror*” të shlyerjes së kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit në datë \*\*\*.9.2005. Kjo lidhje interesi në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit 84/2016, i kualifikon ata si persona të tjerë të lidhur dhe si të tillë kanë detyrimin ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurive të krijuara.

18.1.2 Përkufizimi i pikës 14, të nenit 3, trajtohet më hollësisht në nenin 32, pika 4, të ligjit 84/2016, ku interesi pasuror apo marrëdhënia e biznesit është përcaktuar se shfaqet në format e dhurimit, huamarrjes, huadhënies si raste që hasen më shpesh në praktikë, por që në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk kushtëzojnë dhe kufizojnë kuptimin e interesit pasuror, i cili mund të shfaqet edhe përmes “Hipotekimit”<sup>9</sup>, sikurse jemi në rastin konkret.<sup>10</sup>

18.1.3 Në vijim të asaj çfarë përcakton neni 32, pika 4, e ligjit 84/2016, që këto marrëdhënie duhet të konfirmohen nga subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur apo personi tjetër i lidhur, në vlerësimin e Komisionerit Publik, konfirmimi është i domosdoshëm kur marrëdhënia është e padokumentuar dhe deklarimi konfirmon marrëdhënien, deklarim i cili nuk është i nevojshëm në rastin konkret.

18.1.4 Si rezultat i cilësimit si persona të tjerë të lidhur të këtyre shtetasve<sup>11</sup>, Komisioni do të duhej të vlerësonte drejt mbi sa ka rezultuar nga hetimi pasuror i këtyre personave dhe mbi mundësinë e këtyre shtetasve për t’i krijuar me të ardhura të ligjshme këto pasuri.

<sup>9</sup> Kodi Civil, neni 560, “Hipoteka është një e drejtë reale që vihet mbi pasurinë e debitorit ose të një të treti, në dobi të kreditorit, për të siguruar përmbushjen e një detyrimi.

<sup>10</sup> Fakti që \*\*\* e \*\*\* në funksion të kredisë të marrë nga \*\*\*, për të siguruar përmbushjen e detyrimit të shlyerjes së kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit, i kualifikon ata si persona të tjerë të lidhur.

<sup>11</sup> Në funksion dhe të analizimit të dyshimit të ngritur nga raporti i DSIK-së, ku informohet që subjekti i rivlerësimit investon pasuri në emër të personave të tretë.

18.1.5 Nga aktet në fashikullin e Komisionit (korrespondenca me ZVRPP Vlorë e Tiranë), konfirmohen për shtetasit e sipërpërmendur pasuritë të llojit kullotë dhe apartament. Nga verifikimi i kopjeve të kontratave të vëna në dispozicion rezulton se për pasuritë e konfirmuara nga ZVRPP Vlorë dhe Tiranë, shtetasit \*\*\* dhe \*\*\* kanë shpenzuar gjatë periudhës 2005-2016 minimalisht vlerën prej rreth 40.500.000 lekë, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

**Tab. 2 Vlera e investimit të personave të tjerë të lidhur, \*\*\* e \*\*\*.\*\*\***

<i>Pasuritë e paluajtshme (apartamente, pyll, kullotë)</i>	<i>Viti 2005</i>	<i>Viti 2009</i>	<i>Viti 2010</i>	<i>Viti 2011</i>	<i>Viti 2015</i>	<i>Viti 2016</i>
<i>Total: 40.429.890 lekë</i>	<i>4.350.360</i>	<i>1.807.000</i>	<i>4.718.180</i>	<i>5.557.200</i>	<i>16.875.800</i>	<i>7.121.350</i>

18.1.6 Krahas sa më sipër, nga bankat e nivelit të dytë konfirmohen dhe likuiditete në emër të \*\*\* dhe \*\*\*, respektivisht:

- i. Investime fondi \*\*\* pranë \*\*\* nga \*\*\*.\*\*\*, shuma 2,875,449<sup>12</sup>;
- ii. Depozitë pranë \*\*\* në emër të \*\*\* në shumën 51,354 USD<sup>13</sup> ;
- iii. Obligacione investuar datë \*\*\*.12.2016, shuma 50.000 euro, në emër të \*\*\*;
- iv. Bono thesari investuar datë \*\*\*.10.2010, shuma 1.550.000 lekë, në emër të \*\*\*;
- v. Bono thesari investuar datë \*\*\*.11.2010, shuma 1.400.000 lekë, në emër të \*\*\*;
- vi. Gjithashtu në emër të \*\*\* rezulton dhe investimi në aksione në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. në shumën 25.000 euro<sup>14</sup>, investim i kryer në \*\*\*.3.2016.

18.2 Nga verifikimi i llogarive bankare të vëna në dispozicion të Komisionit për shtetasit e mësipërm rezultojnë transaksione të shumta të kryera për periudhën deri në vitin 2017, të cilat kryesisht janë kryer nëpërmjet veprimeve: *depozitime cash*.

18.3 Në lidhje me mundësitë financiare të këtyre shtetasve për të justifikuar blerjet dhe likuiditetet e konstatuara gjendje me burime të ligjshme, rezulton se Komisioni<sup>15</sup> ka marrë informacion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, mbi punësimet e shtetasve për periudhën deri në vitin 2017. Sipas kësaj shkrese rezulton se shtetasit \*\*\* dhe \*\*\* figurojnë të punësuar respektivisht:

18.3.1 Shtetasi \*\*\*, për periudhën janar 2012 – dhjetor 2017 realizon të ardhura nga punësimi me pagë mujore bruto që variojnë nga 26.250 lekë në 75.000 lekë.

<sup>12</sup> 1.135.000 lekë investuar në vitin 2013 dhe 1.397.000 lekë investuar në vitin 2014.

<sup>13</sup> Çelur në vitin 2012 për 50.379 USD dhe shuma e akumuluar duke iu shtuar interesat deri në vitin 2016.

<sup>14</sup> Shumë e paguar nëpërmjet llogarisë bankare të \*\*\* pranë \*\*\*, datë \*\*\*.3.2016.

<sup>15</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2018.

18.3.2 Shtetasja \*\*\*, për periudhën janar 2012 – dhjetor 2017 realizon të ardhura nga punësimi me pagë mujore që varion nga 66.000 në 95.000 lekë bruto.

18.3.3 Nga ky konfirmim i ISSH-së rezulton se të ardhurat e shtetasve \*\*\* dhe \*\*\* nuk justifikojnë transaksionet e kryera mbi blerjen e pasurive të paluajtshme dhe krijimin e likuiditeteve bankare.

18.4 Komisioni, për sa më sipër, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.<sup>16</sup> Komisioni, me arsyetimin që këta persona të lidhur nuk janë në kushtet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, ka vlerësuar se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ana e subjektit lidhur me këto pasuri duken bindëse dhe se nuk ka dyshime se subjekti rivlerësimi të ketë lidhje me këto pasuri.<sup>17</sup>

18.5 Komisioni ka arritur në konkluzionin se pasuria e personave të tjerë të lidhur, \*\*\* dhe \*\*\*, mundësohet nga prindërit e \*\*\*<sup>18</sup> dhe është e justifikuar me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria private në disa shoqëri tregtare, në të cilat i ati i \*\*\* ka rezultuar një nga ortakët dhe administrator, për periudhën deri në vitin 1999 dhe nga veprimtaria në emigracion pas këtij viti.

18.6 Komisioneri Publik vlerëson se ky konkluzion i Komisionit në vlerësim të provave të paraqitura nuk justifikon burimin e ligjshëm të pasurisë së personave të tjerë të lidhur, për sa vijon:

18.6.1 Subjekti ka arritur të dokumentojë ekzistencën e aktivitetit privat të shtetasit \*\*\*<sup>19</sup>, por nuk ka arritur të sjellë dokumentacion provues të të ardhurave të përfituara nga ky aktivitet, në favor të shtetasit \*\*\*, në mënyrë që të analizohej financiarisht mundësia e investimit nga këto të ardhura. Komisioni duhet të hetonte në organin tatimor mbi shumën e fitimit të shoqërive në fjalë apo t’ia ngarkonte këtë barrë subjektit të rivlerësimit.

18.6.2 Për sa i përket të ardhurave të tyre nga emigracioni, subjekti ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e realizuara nga \*\*\* dhe \*\*\*, në vitet 2015-2016, në \*\*\*, por nga ana e Komisionit nuk rezulton të jetë kryer analizë financiare mbi mbulimin e kostove të jetesës së familjes në \*\*\*, me qëllim përlllogaritjen e përafërt të shumës së mundshme të investuar.

**19.** \*\*\* (nipi i subjektit/ person tjetër i lidhur)

**20.** Shtetasi \*\*\* duhej kualifikuar nga Komisioni si person tjetër i lidhur dhe të justifikonte burimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme për arsyet në vijim:

<sup>16</sup> Referohu f.34, të vendimit të Komisionit.

<sup>17</sup> Referohu f.37, të vendimit të Komisionit, arsyetimi i kundërshtuar dhe më lart.

<sup>18</sup> Mbështetur dhe në deklaratën notoriale të shtetasit \*\*\* nr. \*\*\* rep. \*\*\*, kol. datë \*\*\*.7.2018, përpara noterit \*\*\*.

<sup>19</sup> Nga subjekti janë vënë në dispozicion vendime gjyqate, respektivisht të datës\*\*\*.4.1995, për regjistrimin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe datës \*\*\*.11.1999, të regjistrimit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku administrator dhe një nga ortakët rezulton \*\*\*.

20.1 Nga provat e administruara nga Komisioni rezulton se \*\*\* është shitës i pasurisë së luajtshme automjet<sup>20</sup>, njëkohësisht i punësuar pranë zyrës së noterisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si dhe ka kryer shërbime të tjera në institucione shtetërore në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, pra ekziston një lidhje interesi në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit 84/2016.

20.2 Duke marrë në konsideratë rrethanat faktike të marrëdhënies ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit \*\*\*, që dalin nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, si dhe analogjisë në referencë të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ku në pikën 5 të nenit 3 përcakton si: “*Person i lidhur me një zyrtar*”, çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin<sup>21</sup>, përforcohet qëndrimi për të kualifikuar si person tjetër të lidhur shtetasin \*\*\*.

20.3 Si rezultat i cilësimit si person tjetër i lidhur të këtij shtetasi<sup>22</sup>, Komisioni do të duhej të vlerësonte drejt mbi sa ka rezultuar nga hetimi pasuror dhe mbi mundësinë e tij për t’i krijuar me të ardhura të ligjshme këto pasuri.

20.4 Nga aktet në fashikullin e Komisionit (korrespondenca me ZVRPP Vlorë) konfirmohen pasuri të llojit truall, në emër të shtetasit \*\*\* (në bashkëpronësi me shtetas të tjerë). Nga kontratat e vëna në dispozicion, rezulton se shtetasi \*\*\* vetëm në vitin 2013 ka shpenzuar minimalisht për blerjen e pasurive rreth 10.800.000 lekë.

20.5 Në lidhje me mundësitë financiare të këtij shtetasi për të justifikuar blerjet e konstatuara me burime të ligjshme, rezulton se Komisioni<sup>23</sup> ka marrë informacion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi punësimet e tij për periudhën deri në vitin 2017. Sipas kësaj shkrese figuron se shtetasi \*\*\* është i punësuar pranë subjektit “\*\*\*”, person fizik (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit), prej muajit **nëntor 2015** dhe paguhet me pagë mujore prej 28.154 lekë bruto.

20.6 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale të \*\*\* dhe \*\*\* (prindërit e \*\*\*) me nr. rep. \*\*\* kol. \*\*\*, të datës \*\*\*.7.2018, hartuar përpara noteres \*\*\*, të cilët deklarojnë se këto investime, megjithëse në emër të \*\*\*, janë realizuar me të ardhurat e \*\*\* dhe \*\*\*. Subjekti ka paraqitur dokumentacion për regjistrimin e bizneseve të tyre si person fizik.

<sup>20</sup> Referohu përshkrimit më lart, lidhur me këtë automjet.

<sup>21</sup> Neni 5, “Interesat privatë”, ku përfshihen dhe 5/1/dh, interesa privatë që burojnë nga marrëdhënie familjare dhe bashkëjetese.

<sup>22</sup> Në funksion dhe të analizimit të dyshimit të ngritur nga raporti i DSIK-së, ku informohet që subjekti i rivlerësimit investon pasuri në emër të personave të tretë.

<sup>23</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë \*\*\*.4.2018.



20.7 Nga aktet e paraqitura rezultojn se \*\*\* është regjistruar si person fizik në vitin 2000, me aktivitet “tregti materiale hidraulike, elektrike e të ndryshme”, ndërsa \*\*\*, me vendim të vitit 2007, është regjistruar si person fizik, me aktivitet “tregtimin e artikujve të ndryshëm industrial të pjesëve të ndryshme hidraulike”. Nga ekstraktet e QKB-së të të dyja subjekteve të paraqitura konstatohet se të dyja aktivitetet janë në status aktiv, por nuk rezultojn të jetë vënë në dispozicion të Komisionit ndonjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë xhiron e realizuar dhe të ardhurat e përfituara nga këto aktivitete.

20.8 Nga provat e administruara nga ana e subjektit të rivlerësimit mbi personat e tjerë të lidhur, *si përfundim, sa më sipër*, jemi të mendimit se personat e tjerë të lidhur të trajtuar nga Komisioni, kanë cilësinë e parashikuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, dhe se subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provojë të kundërtën dhe të justifikojë bindshëm krijimin më të ardhura të ligjshme pasurinë e personave të tjerë të lidhur.

## **21. Vlerësimi mbi rezultatet e hetimeve të kryera nga Komisioni lidhur me vilën 3-katëshe, të ndodhur në afërsi të shkollës “\*\*\*\*”, \*\*\***

21.1 Nga përmbajtja e vendimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosje të Komisionit konstatohet se gjatë hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, janë siguruar informacione, të cilat hidhnin dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, ***konkretisht të një shtëpie 3-katëshe dhe truallit mbi të cilën është ndërtuar kjo vilë***. Indiciet e konstatuara i përkasin tri burimeve të ndryshme: (i) informacionit nga organet ligjzbatuese; (ii) informacionit nga denoncimet e publikut, (iii) deklaramet mbi adresën, të bëra ndër vite nga vetë subjekti dhe persona të lidhur me të.

21.2 (i) Informacioni nga organet ligjzbatuese. DSIK-ja<sup>24</sup> ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, ku ndër të tjera ka informuar Komisionin se..... z. Malaj, në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dyshohet për bashkëpunim për përfitime të paligjshme me \*\*\*, gjyqtare pranë kësaj gjykate.....Gjyqtarja \*\*\*, në dhënien e vendimit civil me nr.\*\*\* datë \*\*\*.9.2005, në bashkëpunim dhe në interes të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, z. Malaj, jep një pronësi me parashkrim fitues një pronë publike në qytetin e \*\*\*. Sipas informacioneve rezultojn se shtëpia objekt i vendimit civil gjyqësor është ndërtuar pa leje ndërtimi në vitet 1995-1996 nga babai i z. Artur Malaj”.

21.3 (ii) Informacionet nga denoncimet e publikut. Nga aktet në dosjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në fashikullin e Komisionit, konstatohet se shtetasi \*\*\*, në ankesën e tij, ndër të tjera ka thënë: “...

<sup>24</sup> Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2018.

*kryetari i Gjykatës, z. Artur Malaj, ka ndërtuar shtëpinë e tij, në territorin e gjimnazit ‘\*\*\*’ dhe me gjyqe të manipuluar e ka legalizuar”. Gjithashtu, shtetasi \*\*\*, në denoncimin e tij, ndër të tjera, ka thënë: “...Artur Malaj ... në oborrin e shkollës ‘\*\*\*’ ka bërë vilë 4-kate dhe e ka vënë në emër të \*\*\* së tij”.*

21.4 Komisioni, në lidhje me indiciet e sipërcituara mbi bazën e të cilave ishte krijuar dyshimi lidhur me pronësinë e këtij aseti, shprehet se *këto dyshime u sqaruan nëpërmjet provave të marra gjatë hetimit administrativ, provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore, shpjegime që përputhen me provat e marra si nga Komisioni, ashtu edhe ato të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit.*<sup>25</sup> Komisioni ka shprehur mendimin se prona për të cilën kishte indicie që “de facto” mund të jetë e subjektit të rivlerësimit, është fituar nga z. \*\*\*, në mënyrë të padrejtë, por ajo që është objekt i hetimit administrativ nga ky Komision, është fakti nëse subjekti i rivlerësimit ka apo jo ndikim, apo nëse kjo pronë ka qenë apo është e tij, apo e fshehur në emër të të tjerëve.<sup>26</sup>

21.5 Në këtë kushte, Komisioneri Publik vlerëson se duhej saktësuar origjina e pronës dhe duheshin analizuar të dhënat kontradiktore të rezultuara gjatë hetimit administrativ.

**22. Origjina e pronës.** Nga aktet në fashikull të Komisionit rezulton se e drejta e pronësisë mbi këtë pronë është fituar me parashkrim fitues, nga shtetasi \*\*\*. Nga analizimi i vendimit të Gjykatës Vlorë konstatohet se ky vendim përmban parregullsi sa procedurale, ashtu dhe materiale, për sa vijon:

- i. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me anë të vendimi nr.\*\*\*, datë \*\*\*.9.2005<sup>27</sup>, gjyqtare \*\*\*, i ka njohur paditësit pronësinë mbi një shtëpi banimi prej 90 m<sup>2</sup> dhe mbi një sipërfaqe toke prej 414 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*” \*\*\*.
- ii. Kjo pasuri është fituar me parashkrim fitues, referuar nenit 169 të Kodit Civil<sup>28</sup>. Konstatohet se pasuria shtrihet në truall pronë shtetërore dhe Kodi Civil, neni 168, paragrafi i fundit, parashikon qartazi që nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme.
- iii. Në zhvillimin e seancës gjyqësore lidhur me faktet dhe rrethanat, konstatohet se vendimi është bazuar në thëniet e dy dëshmitarëve, të cilët nuk dëshmojnë, përveçse e kanë me të dëgjuar se në atë banesë jetonte shtetasi \*\*\*, dhe tjetri që konfirmon thjesht që aty ka një banesë.
- iv. Pretendohet që ndërtimi është bërë që nga viti 1984, mbi bazën e lejes së organeve kompetente, ndërkohë që sipas aktekspertimit të datës \*\*\*.9.2005, hartuar nga ing. \*\*\*,

<sup>25</sup> Referohu f. 29, paragrafi 6 i vendimit të Komisionit.

<sup>26</sup> Referohu f.28, paragrafi 6 i vendimit të Komisionit.

<sup>27</sup> Në këtë kohë, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Gjykatës Vlorë.

<sup>28</sup> Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për 20 vjet, në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj.

pjesë e dosjes gjyqësore, rezulton *se nga materiali i përdorur si dyer, dritare etj., kjo banesë është ndërtuar afërsisht para 10-12 vjetësh, pra në vitet 1993-1995.*

- v. Nga aktet në dosjen gjyqësore mungon leja e organeve kompetente të atyre viteve. Paditësi ka sjellë si prova mbështetëse vetëm një vërtetim që nuk ka prona të regjistruara në emër të tij, në ZVRPP Vlorë. Mungon njoftimi dhe prezenca e avokaturës së shtetit, në seancat gjyqësore, në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile<sup>29</sup>.
- vi. Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se kjo pronë në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme është regjistruar me sipërfaqe tjetër, më të madhe nga sa është shprehur gjykata në vendimin e saj. Komisioni në përmbajtjen e vendimit, para kalimit të barrës së provës së subjektit për këtë pasuri, shprehet se *manipulimet e ndodhura në ZVRPP-në Vlorë mund të kryheshin vetëm nën ndikimin e subjektit të rivlerësimit.*<sup>30</sup>

22.1 Gjyqtarja që ka dhënë vendimin, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, është subjekt rivlerësimi dhe si e tillë parimisht do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*. Komisioni, duke qenë i bindur se kjo pronë është fituar në mënyrë të padrejtë nga z.\*\*\*, siç shprehet në përmbajtje të vendimit, mund të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit të gjyqtarës së çështjes. Një vendim i tillë i Komisionit do t'i shërbente jo vetëm procesit, por dhe rritjes së besimit të publikut në këtë proces dhe, në njëfarë mënyrë, rivendosjen e një drejtësie të munguar në vite.

22.2 Duke qenë të vetëdijshëm për parashikimet kushtetuese dhe të faktit që procesi i rivlerësimit nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara nga subjektet e rivlerësimit, gjithsesi mbetet detyrim ligjor, në rast të konstatimit të elementeve të tjera përveç shkeljes disiplinore, për të dërguar dosjen pranë organeve të tjera kompetente për vlerësimin e saj, gjë e cila do të ndihmonte në sqarimin e dyshimeve që një karakter hetimi administrativ nuk i jep dot zgjidhje.

**23. Deklarimet kontradiktore të shtetases \*\*\*<sup>31</sup>.** Shtetasja \*\*\*, e thirrur në cilësinë e dëshmitares për të sqaruar rrethanat dhe faktet e mësipërme, ka bërë deklaramë kontradiktore, të cilave vetë Komisioni u referohet në vendim<sup>32</sup>. Komisioni, në bazë të dyshimeve të ngritura, i ka kaluar subjektit barrën e provës, i cili, në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, ka detyrimin për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

<sup>29</sup> Neni 79/a "Avokatura e shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata që shqyrton çështjen, për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga avokatura e shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim".

<sup>30</sup> Referohu f. 27, pika 9 e vendimit të Komisionit.

<sup>31</sup> \*\*\* e subjektit të rivlerësimit, e bija e z.\*\*\*, pronar i origjinës së truallit ku ndodhet vila.

<sup>32</sup> Referohu f. 26-27 të vendimit të Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke ngritur pretendimet lidhur me dyshimet e ngritura nga ana e Komisionit për këtë pasuri, duke paraqitur edhe provat përkatëse<sup>33</sup>.

23.1 Referuar këtyre akteve, si dhe provave të marra gjatë hetimit administrativ, Komisioni arriti në përfundimin se nuk provohet fakti se subjekti i rivlerësimit të ketë fshehur pasuri në emër të personave të tjerë, konkretisht të një vile 3-katëshe dhe truallit mbi të cilën është ndërtuar kjo vilë.

23.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklaratimet kontradiktore të shtetasës në fjalë, si dhe të dhënat e administruara nga Komisioni në funksion të hetimit administrativ, nuk arritën të provojnë të kundërtën e përpjekjes së subjektit për të fshehur pasuritë e tij, sipas D/5 të aneksit të Kushtetutës.

Konkretisht:

- i. Gjatë hetimit administrativ nuk u provua se shtetasja \*\*\* apo i ati i saj të kenë jetuar ndonjë ditë në banesën/vilën në pronësi “de jure” të tyre. Subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, ka deklaruar se: në vitin 1996, *mamaja ime, vëllai im dhe dy motrat janë larguar nga fshati dhe janë spostuar me banim në qytet dhe atje kanë marrë me qira shtëpinë e z.\*\*\**. Ndërkohë subjekti, në përgjigjet e pyetësorëve deklaroi se i vëllai është emigrant që në vitin 1991.
- ii. E ëma e subjektit dhe i vëllai i subjektit, familjarët e tij kanë jetuar atje deri në vitin 2009, vit në të cilin vila u rikonstruktua. Sipas shtetasës \*\*\*, i ati kishte lidhur kontratë qiraje me to, me një qira rreth 7.000 ose 9.000 lekë në muaj. Nuk figuron të jetë provuar/dokumentuar marrëdhënia e qirasë.
- iii. Shtetasja \*\*\* ka deklaruar që: *kjo banesë është ndërtuar rreth viteve 1991-1992, dhe se ishte investim i parave të gjyshit, i cili pretendon se i ka lënë trashëgimi të atit në vitin 1990, rreth 2.000.000 lekë. Kur ndërtesa u ndërtua gjyshi vdiq, dhe ne nuk jetuam aty, pasi na binte më mirë të ishim te banesa në pallat.*
- iv. Rivendosim në vëmendje se ka kontradiksione midis atyre që ka thënë i ndjeri \*\*\* në ngritjen e padisë sa i përket vitit të ndërtimit dhe qëllimit dhe atyre që ka thënë \*\*\* në deklaratimet e saj në Komision.
- v. Kontrata e sipërmarrjes paraprake nr.\*\*\* rep. \*\*\* kol, datë \*\*\*.4.2008, për ndërtimin e vilës është redaktuar nga notere \*\*\*, bashkëshortja e subjektit, që e shkëputur si indicie nuk përbën provë mbi pronësinë faktike të subjektit mbi këtë pronë, por që i shtohet klasifikimit të fakteve dhe rrethanave, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dijeni mbi “fatin” e kësaj prone.

---

<sup>33</sup> Referohu f. 27 të vendimit të Komisionit.

- vi. Referuar deklarimeve të shtetases \*\*\*, konstatohet se kjo shtetase nuk mund të dokumentojë që ndërtimin e kësaj prone, me një vlerë rreth 14.000.000 lekë, ta ketë realizuar me të ardhura të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që, *nëse kjo është e vërtetë, le të zbatohet ndaj saj ligji, pasi unë nuk kam asnjë lidhje me të, as gjinie, as krushqie.*
- vii. DSIK-ja, në dërgimin e raportit për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ka informuar se kjo pasuri është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, se ai dhe familja e tij e kanë ndërtuar atë dhe se kanë banuar aty edhe mbas ndërtimit. Komisioni është mjaftuar nga fakti që i ati i subjektit të rivlerësimit ka vdekur në vitin 1993 dhe informacionet e DSIK-së i referohen si vit ndërtimi, nga babai i subjektit të kësaj prone, viteve 1995-1996.

23.3 Nisur nga sa analizuam më lart mbi origjinën e fitimit të kësaj prone, deklaratat kontradiktore të shtetases \*\*\* marrin më shumë vlerë së bashku me elementet e tjera kontradiktore dhe pasurore të rezultuara nga hetimi administrativ, lidhur me pronësinë “*de jure*” dhe “*de facto*”, në shërbim jo vetëm të indicieve mbi pronësinë e subjektit mbi këtë vilë, por dhe në shërbim të indicieve të organeve ligjzbatuese, të cilat kanë referuar se kanë informacion që subjekti investon pasuritë në emër të të tretëve.

**24. (iii) Deklarime mbi adresën, të bëra ndër vite nga vetë subjekti dhe persona të lidhur me të**  
Subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë pranë ILDKPIK-së ka deklaruar<sup>34</sup> si adresë banimi, pikërisht vilën e ndodhur në l. “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, dhe më konkretisht në deklaratat periodike nga viti 2004 (*për v. 2003*) deri në vitin 2012 (*për v. 2011*). E njëjta adresë është plotësuar dhe nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

a. Lidhur me deklarin e vendndodhjes së vilës si adresë, subjekti është justifikuar me faktin se është shënuar në formular, pasi ka qenë adresë e regjistrimit në gjendjen civile, dhe jo adresë në të cilën ka jetuar<sup>35</sup>. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë saktë adresën.

b. Për më tepër dhe argumenti i subjektit që formulari i referohej *adresës së gjendjes civile dhe mosndryshimi i saj është neglizhencë*<sup>36</sup> nuk qëndron, për arsye se subjekti, për shkak të pozicionit që ka dhe njohurive që mbart, duhet të vlerësojë seriozitetin në pasqyrimin e të dhënave në formularët e

<sup>34</sup> Duke filluar nga DV 2004 për vitin 2003, deri në DV 2012 për vitin 2011.

<sup>35</sup> Referohu sqarimeve të subjektit, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, në dosje të Komisionit.

<sup>36</sup> Referohu përgjigjes në pyetësorët nga ana e subjektit.

ILDKPKI-së, si dhe faktin që çdo “neglizhencë” ngarkon me përgjegjësi subjektet që mbartin detyrimin për të deklaruar.

c. Komisioni është bindur nga shpjegimet e subjektit lidhur me faktin se ajo është adresë e gjendjes civile dhe se ai nuk ka jetuar aty, duke marrë të mirëqenë shpjegimet e dhëna nga subjekti se ka jetuar në banesën e të vëllait.

i. Në përgjigje të pyetësorit të parë, subjekti deklaroi se nga janari 2011 deri në gusht 2011 ka jetuar në \*\*\*, në banesën e të vëllait \*\*\* Malaj, l. “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”.

ii. Në përgjigje të pyetësorit tjetër, subjekti ka deklaruar se nga fundi i vitit 2008 deri në shtator 2011 ka banuar te shtëpia e vëllait, pa paguar qira. Nga shtatori 2011 e në vazhdim ka deklaruar se ka jetuar në shtëpinë në \*\*\*, në adresën që më pas e ka saktësuar dhe në formularët e deklarimit.

iii. Komisioni duhej të kishte vlerësuar që sqarimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë, pasi dukshëm nga dokumentacioni në dosje rezulton se i vëllai i subjektit të rivlerësimit është bërë pronar i **dy apartamenteve** në lagjen “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, vetëm me \*\*\* **nëntor 2011**<sup>37</sup>. Subjekti e kishte të pamundur të jetonte në një pronë të cilën vëllai as vetë nuk e zotëronte deri nga fundi i vitit 2011, duke mos arritur kështu të shpjegojë bindshëm të ketë jetuar në një adresë tjetër përveç asaj të deklaruar. Për më tepër, ky fakt rezulton i dokumentuar nga prokura e posaçme nr.\*\*\* rep. \*\*\* kol, datë \*\*\*.9.2011, lidhur në prani të noteres \*\*\* (bashkëshortja e subjektit), me anë të së cilës z. \*\*\*, autorizon motrën e tij \*\*\*, të aplikojë pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Vlorë, për pajisjen me certifikatë pronësie të pasurive të blera, sipas kontratave të shitblerjes.

**25. Në përmbledhje**, nga tri burimet e informacionit, të trajtuara hollësisht më lart, mbetet akoma e paqartë se kur, kush dhe pse e ndërtuan këtë vilë. Ajo që del nga deklaratimet dhe faktet është se kjo banesë është fituar nga një vendim gjyqësor që lë vend për interpretim. Është shfrytëzuar për një kohë relativisht të gjatë nga familjarët e subjektit të rivlerësimit dhe është përdorur si adresë nga subjekti vetë.

**26. Sa më sipër parashtruar**, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij, duke mos arritur të provojë të kundërtën dhe bazuar në nenin D/5, të aneksit të Kushtetutës, mbi të duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit.

## **27. Kërkimi i ankimit**

**28. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit, C/2, Ç, D dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin**

<sup>37</sup> 1. Kontrata e shitblerjes nr.\*\*\* rep.\*\*\* kol, datë \*\*\*.11.2011, blerës \*\*\* dhe shitës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Objekt ap. me sip.45, 2 m<sup>2</sup>, çmimi i shitblerjes 2.600.000 lekë. 2. Kontrata e shitblerjes nr.\*\*\* rep.\*\*\* kol, datë \*\*\*.11.2011, blerës \*\*\* dhe shitës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Objekt ap. me sip.55 m<sup>2</sup>.Nuk figuron çmimi në kontratën që disponohet në dosje.

e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pronat në përdorim posedim apo disponim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur, si dhe nuk ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të krijimit të tyre nga personat e tjerë të lidhur, me qëllim arritjen e një niveli të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

**29.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**30.** Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

**31.** Bazuar në nenin D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

**32.** Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

Darjel Sina

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2018, i ONM-së.

2. Shkresa nr. \*\*\* prot. datë \*\*\*.8.2018, denoncim i shtetases \*\*\*, e cila pretendon se ky gjyqtar, z. Malaj, me vendime të padrejta, ka cenuar interesa legjitime, duke u sjellë shumë qytetarëve cenim të së drejtës kushtetuese të pronësisë.